

## Rreth mërzisë

Sa i përket mërzisë, kjo nuk është urdhëruar as nga Allahu ﷻ e as nga i Dërguari i Tij ﷺ. Madje, në disa vende na është ndaluar të mërzitemi, edhe nëse kemi të bëjmë me çështje të fesë, si në ajetet e Allahut ﷻ:

‘Mos u ligështoni (karshi armikut) e as mos u mërzitni. Ju do të keni epërsi, nëse vërtet jeni besimtarë.’ (Aal Imran, 139)

‘Mos ki mërzi për ta (idhujtarët, etj.) e as mos u shqetëso nga komplotet e tyre.’ (en-Nehl, 127)

‘Dhe ai (pejgamberi ﷺ) i tha shoqëruesit të tij (Ebu Bekrit): ‘Mos u brengos, se Allahu është me ne.’ (et-Teubeh, 40)

‘Mos lër të të mërzisnin fjalët e tyre (O Muhamed).’ (Junus, 65)

‘... që të mos mërzitesh për gjërat që s’i arrin dhe të mos ngazëllesh për atë që të është dhënë.’ (el-Hadid, 23)

Ka dhe shumë shembujt të tjerët të ngjashëm.

Kjo sepse mërzia nuk sjell kurrfarë dobie e as nuk largon ndonjë dëm. Pra, ajo nuk i shërben ndonjë qëllimi dhe Allahu ﷻ nuk urdhëron për çfarëdo qoftë që nuk i shërben ndonjë qëllimi.

Mërzia apo pikëllimi mund të sinjalizojnë për diçka për të cilën njeriu mund të shpërblehet dhe të lavdërohet. Në këtë kuptim, mërzia është e lavdërueshme, por jo e lavdërueshme në vetvete. Për shembull, njeriu mund të mërzitet nga ndonjë fatkeqësi që ndikon në përkushtimin e tij fetar apo dhe të pikëllohet nga belatë që i godasin muslimanët në përgjithësi. Personi i këtillë do të shpërblehet për atë çfarë ndien në zemër nga dashja e së mirës dhe urrejtja e së keqes dhe të ngjashmet me këto.

Mirëpo, nëse kjo çon në dëshpërim dhe në heqje të vëmendjes nga ajo çfarë urdhëruan Allahu ﷻ dhe i Dërguari i Tij ﷺ, atëherë kjo është e qortueshme, ndonëse e gjejmë të jetë e lavdërueshme në disa aspekte të tjera. (Shejhul-Islam Ibn Tejmije, *Mexhmu el-Fetaawa* 10/16-17)

Ibn el-Kajjim tha:

Pejgamberi ﷺ e konsideroi mërzinë si diçka nga e cila duhet kërkuar shpëtim te Allahu ﷻ, meqë mërzia çon në dëshpërim, dobëson qëndresën dhe shemb vullnetin. S’ka gjë më të dashur për Shejtanin sesa mërzia e besimtarit. Allahu ﷻ thotë:

‘Bisedat e fshehta (komplotet) vijnë nga shejtani, me qëllim që t’i mërzisë besimtarët.’ (el-Muxhaadileh, 10)

Mërzia është një nga sëmundjet e zemrës (sëmundje shpirtërore), që pengon njeriun nga këndellja dhe nga dhënia e mundit ... Mërzia mund të jetë e lavdërueshme vetëm atëherë kur kemi të bëjmë me një shkak apo burim, përndryshe mërzia në vetvete nuk është e lavdërueshme në asnjë rrethanë.

Besimtari mund të ndiejë mërzi për moskujdesin në adhurimin ndaj Zotit apo për teprim në kundërshtim a mosdëgjim ndaj Tij, si dhe për humbje të kohës. Kjo, në fakt, tregon për gjendjen e mirë të imanit dhe për mirëqenien shpirtërore, duke qenë se zemra e tij ndien këtë dhimbje.

Megjithatë, kur zemra e tij është e vdekur (shpirtërisht), ai nuk mërzitet (për mospërbushjet) dhe as nuk ndien dhimbje, meqë i vdekuri nuk ndien dhimbjen e plagëve. Sa më e gjallë shpirtërisht që është zemra e njeriut, aq më shumë ai do ta ndiejë këtë dhimbje.

Sido që të jetë, mërzia nuk ndihmon aspak, meqë ajo çon në dëshpërim. Zemrën do ta ndihmojë vetëm një mendje e përqendruar dhe puna me zell.” (*Tarik el-Hixhretejn* 2/607-608)